VENDIM
Nr.222, datë 27.1.2009

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 8300 M², NGA ALBAKËR SHA, MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.336, DATË 1.6.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ALBAKËR SHA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushettutës dhe të neneve 8, pika 3, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të sipërfaqers 8300 (tetë mijë e treqind) m^2, me vlerë kontabël 2 656 000 (dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, nga "Albakër" sh.a. në likuidim e sipër, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për shesh ndërtimor, për ndërtimin e segmentit rrugor "Milot-Rrëshen".

2. Kjo sipërfaqe, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme të Albakër sh.a. të miratuar me vendimin nr.336, datë 1.6.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Albakër sh.a.", të ndryshuar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, që, përpara fillimit të punimeve në pjesën e territorit të uzinës, që do të përdoret si shesh ndërtimi:

a) të ndërtojë murin rrethues të uzinës së rafinimit të bakrit, Rubik, në kufijtë e territorit, që mbetet në administrim të uzinës;

b) të ndërtojë rrjetin nëntokësor të furnizimit me ujë të uzinës, që ndodhet në sheshin e ndërtimit, që i kalon në administrim të DPRR-së, sipas projektit të miratuar nga Albakër sh.a. në likuidim.

4. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e kësaj prone.

5. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ALB-BAHER CORPORATION SH.A. TIRANA



MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANS
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E R

Andi TOMA

Drejtor i Pergjithshem

egis

"MILOT-RRESHEN" HIG
"DURRES - MORINE" CO
LOT 2

PUBIK INTERCHANGE
GENERAL LAYOUT

1:1 000
A3



MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORT
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGE

Andi TOMA

Drejtor i Pergjithshem

egis road

"MILOT-RRESHEN" HIGHWA
"DURRES - MORINE" CORRID
LOT 2

RUBIK INTERCHANGE GENERAL LAYOUT	1:1 000 A3	From Km 16+600 To Km 17+430